



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 54, Datë 07.03.2018**

**MBI**

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“AED SOLAR” SH.P.K, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPJANTI FOTOVOLTAIK TOPOJË ME KAPACITET  
PRODHUES 1998 KW.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; nenit 8, nenit 10, pika 2 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17 .06.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi mos fillimin e procedurës për Licencimin e shoqërisë “AED Solar” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik Topojë me fuqi të instaluar 1998 KW,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën me nr. 3 Prot, datë 01.02.2018, shoqëria “AED Solar” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, Bashkia Fier me kapacitet prodhues 1998 kW.
- Autorizimi me nr. 4867/6 Prot., datë 27.10.2016, i lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i paraqitur në ERE nga subjekti “AED Solar” sh.p.k., nuk i përket kësaj shoqërie por shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k.
- Rezulton se aplikuesi, shoqëria “AED Solar” sh.p.k., nuk ka autorizim të vlefshëm për këtë aplikim sipas nenit 3 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”.
- Në bazë të nenit 3 të VKM nr.822 datë 07.10.2015 “Për Miratimin e Rregullave dhe Procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni” theksohet se akti administrativ, i cili i jep mbajtësit të saj të drejtën për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt

koncesioni, miratohet nga Ministri, për objektet deri në 2 MW, ndërsa mbi 2 MW, nga Këshilli i Ministrave.

- Aplikimi i shoqërisë “AED Solar” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, (neni 9, pika 1, gërmat “a“, “b“, “c”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, (neni 9, pika 2, gërmat “a“, “b“, “c“, “e”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a“ dhe “b” paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për Impiantin Fotovoltaik, (neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3 gërmat “a”, “b”, “d”; pika 4.4.4 gërmat “a”, “b”, “d”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 2 gërma “d“ (Vërtetim datë 20.12.2017, lëshuar nga Gjykata Penale e Shkallës së Parë Tiranë për përfshirje ose jo në një proces penal); gërma “f” (Marrëveshje ose autorizimi nga KM); gërma “g” (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti),
- Neni 9 pika 3 gërma “c“ (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe gërma “d“ (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s, e kryer pjesërisht);
- Neni 9 pika 4.4.3 gërma “c” (Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria; pika 4.4.4 gërma “c” (Oponenca teknike e projektit); gërma “e” (Miratimi i zbatimit të projektit nga MIE) dhe pika 4.4.5 (Leje nga institucione të tjera),

do të njoftohet subjekti që në zbatim të nenit 10 pika 7 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*, t’i paraqesë ato në ERE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik Topojë me fuqi të instaluar 1998 kW.
2. Nëse shoqëria “AED SOLAR” paraqet aplikimin e ri në perputhje me pikën 6 të nenit 10 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi

dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**